



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. REZEART XHELAL TUSHA, KANDIDAT PËR DEPUTET I
PROPOZUAR NGA KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE- ALEANCA PËR NDRYSHIM, QARKU
DURRËS

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë”, sipas parashikimeve të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, qarku Durrës, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr.2234 unik.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.3915 prot, datë 18.04 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 4158/1 prot, datë 20.04.2021, ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet z. Rezeart Xhelal Tusha, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2213 prot, datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1158/1 prot, datë 08.04.2021, ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për Deputet z. Rezeart Xhelal Tusha, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar përbërësit e gjëndjes civile, konkretisht ka ndryshuar rubrikën e emrit nga “Dritan” në “Rezeart” me vendimin nr.122 datë 03.11.1972.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.156 datë 17.03.2021 vendosi “Miratimin e listave shumëmemërore të koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Rezeart Xhelal Tusha.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Rezeart Xhelal Tusha, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pyetjes 7, “A është marrë për ju ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

-Është marrë masë dëbimi në Zvicër për shkak të tejkalimit të lejes së qëndrimit;

-Është ndaluar në vitin 1994-1995 dhe i komunikojnë që i ka mbaruar leja e qëndrimit dhe duhej të largohej nga shteti Zvicerian. Pas disa vitesh ka hyrë disa herë të tjera në shtetin Zvicerian , për të cilin nuk hasur probleme;

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

-Ka jetuar në Zvicër, Kanton Graubunden, për arsye emigracioni, për periudhën tetor 1994-1995.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave

të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2442 prot., datë 22.03.2021, vendosi t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 518/66 prot., datë 08.05.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Rezeart Xhelal Tusha, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Rezeart Xhelal Tusha, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Dritan” në “Rezeart” të pa deklaruar në formular;
- Rezulton të ketë përdorur në Zvicër gjenealitetet Kastriot Prekazi lindur më 25.05.1971 dhe Rezart Tusha lindur më 01.06.1972;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë nga autoritetet gjyqësore shqiptare ose të huaja;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një veprë penale;
- Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar/arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerje të një veprë penale;
- Nuk rezulton ndaj tij të jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale prej tij;
- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti të huaj;
- Rezulton i regjistruar për qëndrim të paligjshëm në Zvicër dhe është kthyer në vendin e tij të orgjinës në datën 13.01.1994.

Për sa më sipër subjekti vetëdeklarues, z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i subjektit politik, Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim qarku Durrës, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 408, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, në zonën zgjedhore qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim ka fituar 6 (gjashtë) mandate dhe z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat i listës shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, qarku Durrës, nuk ka marrë mandatin e deputetit.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. REZEART XHELAL TUSHA, KANDIDAT PËR DEPUTET I
PROPOZUAR NGA KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR NDRYSHIM, QARKU
DURRËS**

Sot më datë. 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat i propozuar për deputet nga Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, qarku Durrës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat i propozuar për deputet nga Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Data: dd mm vvvv Nr:
Ora: hh:mm



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim Qarku Durrës

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për deputet”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, qarku Durrës, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr.2234 unik.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.3915 prot, datë 18.04 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 4158/1 prot, datë 20.04.2021, ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet z. Rezeart Xhelal Tusha, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2213 prot, datë 17.03 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1158/1 prot, datë 08.04.2021, ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për Deputet z. Rezeart Xhelal Tusha, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile, konkretisht ka ndryshuar rubrikën e emrit nga “Dritan” në “Rezeart” me vendimin nr.122 datë 03.11.1972.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.156 datë 17.03.2021 vendosi “Miratimin e listave shumëmemërore të koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Rezeart Xhelal Tusha.

Data: dd mm vvvv Nr:
Ora: hh:mm



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim Qarku Durrës

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Rezeart Xhelal Tusha, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pyetjes 7, “A është marrë për ju ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

-Është marrë masë dëbimi në Zvicër për shkak të tejkalimit të lejes së qëndrimit;

-Është ndaluar në vitin 1994-1995 dhe i komunikojnë që i ka mbaruar leja e qëndrimit dhe duhej të largohej nga shteti Zvicerian. Pas disa vitesh ka hyrë disa herë të tjera në shtetin Zvicerian , për të cilin nuk ka hasur probleme;

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

-Ka jetuar në Zvicër, Kanton Graubunden, për arsye emigracioni, për periudhën tetor 1994-1995.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2442 prot., datë 22.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 518/66 prot., datë 08.05.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Rezeart Xhelal Tusha, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Rezeart Xhelal Tusha, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Dritan” në “Rezeart” të pa deklaruar në formular;
- Rezulton të ketë përdorur në Zvicër gjenealitetet Kastriot Prekazi lindur më 25.05.1971 dhe Rezart Tusha lindur më 01.06.1972;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë nga autoritetet gjyqësore shqiptare ose të huaja;

- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar/arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerje të një vepre penale;
- Nuk rezulton ndaj tij të jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti të huaj;
- Rezulton i regjistruar për qëndrim të paligjshëm në Zvicër dhe është kthyer në vendin e tij të orgjinës në datën 13.01.1994;

Për sa më sipër subjekti vetëdeklarues, z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i subjektit politik, Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim qarku Durrës, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 408, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, në zonën zgjedhore qarku Durrës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim ka fituar 6 (gjashtë) mandate dhe z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat i listës shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, qarku Durrës, nuk ka marrë mandatin e deputetit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, qarku Durrës, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të deputetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv Nr:
Ora: hh:mm



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim Qarku Durrës